



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLEDHJES SË PESTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 27.05.2022 (e Premte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredini, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Jakup Demiri, Liridona Bislimi, Sejdi Emini, Nexhat Halili, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Majlinda Shabani, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Vilsona Maliqi-Salihu, Zyrafete Rama, Veton Ramadani, Anisë Zejnullahu, ndërsa mungoj Reshat Azizi, Taibe Ibrahim, Sokol Shaqiri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e peste të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë!

**z.Basri Sylejmani:** Unë i kam dy pyetje. Ujin, ujësjellësin e Sodovinës, Terstenikit dhe Sllatines. Kjo është hera e katërt që e potencoj për këtë çështje. Drejtori nuk qenka këtu, më mirë të thërrasim komisionin për shërbime publike. Uji i Sadovinës, Tërstenik, Sllatinë mu lëshu ke qysh ke. Ne e dimë se uji i pijshëm nuk është për momentin, se kompania si ka përmbush kërkesat e ujit qysh duhet. E tash ne kem mungesë të ujit, sidomos Sodovina, mahalla Fetahaliqi ka mungesë të ujit. Ma së pari në të është uji, por për vaditje për këtë bën, dhe kryetari qenka këtu, në të jep. Dhe çështja e dytë për semaforin në Viti. Unë e shoh atë semafor si me qenë dardhë a mollë, që dhjetë here e potencoj, e thirr drejtorin e inspektionit. Ka thënë unë s’kam kompetenca. Kush i ka kompetencat janë pesë inxhiniera, nuk e di se çka do të bëjnë me atë semaforë, ajo duhet mu tërhek te pllaka mu afër aty dhe ajo nuk ka pengesë më. Dikush thotë e ka ky inxhinier, tjetri ky, unë s’di kujt me ju drejtu, se drejtori Basria erdh. Unë e bëra kërkesën e ujit për Sodovinë të Jerlive, Muhaxherve, Tërstenik dhe Sllatinë, se te na nuk ka ujë pastrues në Sodovinë, ju duhet me lëshu ujin, jepja kompanisë, pagesa bëhet, s’jem ne tu i ik pagesës. Jepja kompanisë cila e merr ose ne ta merr një firmë private, kaq nuk kam më shumë.

**z.Illir Zuka:** Përshëndetje kryesues, drejtor, asamblistë dhe media! Unë i kam 3-4 pyetje shumë shkurtë. Kem pas takim administratorët e fshatrave, mu kanë një punëtori dhe me rrotullu që është 02/2019 Komuna e Vitisë, domethënë gjashtë takime me ia pagu asamblistëve. Ju kisha lutë, është kërkesë e administratorëve të fshatrave, ndërmjet kësaj rregullore do t’ia dërgojmë lëndën në gjykatë. Kështu që, për mos me shku në gjykatë, ato procedura dihet që duhet me pagu pak më shumë komuna, kështu që duhet me bërë një marrëveshje komuna

është kërkesa e administratorëve të fshatrave nuk është kërkesë e imja. Dashta të lidhem edhe te uji, kam pas edhe unë një takim me fshatin Tërstenik, ata janë të interesum me i mbledh parët, një pjesë i kanë grumbullu, për pagesë, masi është problem i madh, kur e dimë se ai fshatë ka shumë probleme me ujin, sidomos në kohën e Verës iu kisha lutë të bëjmë një marrëveshje, ne ta paguajnë ata. E kemi drejtoreshën e Arsmi, s'di çka ka ndodhë, unë dje kam marr informatë, nuk është shumë e sigurt, por me ka ardh me të thënë të drejtën që operatorit për shkollën e Pozheranit. Ju ka ndërpre kontrata. Nënkryetar, a keni ndonjë informatë. Kam edhe një pyetje për drejtorin e administratës, për parkingin mbrapa komunës, për punëtorët e komunës. A është ndërmarr naj send rreth asaj çështje.

**znj.Liridona Bislimi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Para disa ditësh kam bërë një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, ku kam kërkuar, mungesën e investimeve në rrugën “Brigada 173”, e cila gjendet mes qendrës së qytetit. Banorët e kësaj rruge janë kategoria e parë të tatim, paguesve, ndërsa sipas këtyre investimet janë në nivelin më të dobët. Kam kërkuar si informacion të di se cilat janë planet komunale rreth kësaj rruge, prandaj investimet dhe punët, edhe pse nuk është punuar deri tash, pasi që nga mungesa e investimeve komunale dhe bizneset që kanë qenë aty funksionale afër njëzet biznese janë larguar, besoj se paraprkishtë mund ta kemi një përgjigje për banorët e kësaj rruge. Në mbledhjet e kaluar kam bërë disa pyetje për drejtoreshën e arsimit, e cila ka munguar dhe tash po mungon. Besoj duhet të na kish dedikuar përgjigjet të paktën përmes email zyrtar, prandaj unë po vazhdoj pyetjen: a ka pas ankesa nga komisioni për ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Më intereson ta di nga kjo që e ceka më lartë, ka pas një kosto mjaft te madhe dhe nëse ka mundësi ta kem një përgjigje, qoftë këtu qoftë me shkrim.

**znj.Majlinda Shabani:** Përshëndetje për të gjithë. Paraprkishtë para se me konsulltu në temën qe ka me fol për sot, po besoj që uji dhe kanalizimi është njëra ndër çështjet dhe pyetjet, se secili prej këshilltarëve ka mi ngrit. Edhe unë vetë si asamblistë pata me e ngrit këtë çështje. Mbase kryetarin nuk e kemi këtu, e kemi nënkryetarin. E di që gjatë kohës së fushatës ka premtu që ky problem ka me u zgjidhë qysh katërmujorshin e parë të qeverisjes, edhe ne po ankohe mi për këto problematika. Po du me pyet nënkryetarin, se ku është problemi, ku kanë ngec këto punë, për shkak se kompetencat i dimë se kujt i takojnë. Pyetja tjetër po du mu fokus te sektori i bujqësisë për gjatë gjithë muajit Mars-Prill. Kam pas takime me fermer radhazi janë anku për mënjanimin e punës që bëhet nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë. Secila komunë ka bërë ndarje të subvencioneve. E dimë që Komuna e Vitisë ka bërë hapin e parë për subvencionimin, subvencionim ky që nuk është realizu, a me arsyetim që është vonu. Në bazë kësaj unë po du me ritheksu, se tha kem pa që kemi shumë shpenzime që bëhen lluksi. Në anën tjetër shohim se fermerët të paktën munden mu subvencionu me makineri, që kish bo me lehtësu punën e tyre. Po du me pyet, pse deri tash nuk është bërë kurgja për fermerët e kësaj komune, tu e ditë çfarë potenciali ka Komuna e Vitisë. Realisht kam pa një lloje neglizhimi shumë të madh sa i përket këtij sektori. Dhe pyetja tjetër ka të bëjë pikërisht me çështjen që ka ngrit deputetja, znj.Mirlinda Tishukaj-Sadiku, projektin për sistemin e ujitjes në fshatin Skifteraj. Po besoj që kemi pas rast me ndëgju edhe arsyetimin edhe akuzën që kryetari e ka bërë, që ky bashkëpunim të filloj. Bashkëpunim është anulë për shkakun e ministrisë, edhe në fakt faji ka qenë pikërisht prej anës së komunës, për shkak që nuk është, nuk përmban rregullores. Nëse keni arsyetim prej anës së drejtorit, që ky vonim është bërë për shkak se keni pas vonesa në termin, po du me i informu drejtorin, a je i informum që gjatë asaj kohe Ministria e Bujqësisë ka bërë thirrje edhe ka nda buxhet pikërisht për këtë investim. Pse ju si komunë nuk keni bërë asnjë kërkesë për këtë çështje.

**z.Taulant Haxhiu:** Përshëndetje për të gjithë! Unë e kam pyetjen e parë, seancat e Kuvendit Komunal të Vitisë, nuk ka pas transmetim direkt. Me sa e di është bërë një kontratë tash me një televizion lokal, seancat duhet të transmetohen drejtpërdrejtë për shkak se këshilltarët e kanë mu lehtu nga qytetarët tanë, duhet të përfaqësohen dhe te shohin cilën përformncë e kanë nga qytetarët e Vitisë. Pyetja e dytë është për z.Naim Pira,

drejtor i bujqësisë, aplikimi i fermerëve, a zgjatet afati hala dhe a kanë arrit me apliku të gjithë fermerët? Pyetja e tret është për drejtorin e urbanizmit, z.Visar Demiri: si është duke shku puna me projektimin e planit zhvillimor? Dhe pyetjen e katërt e kam për drejtorin e financave, z.Besnik Imeri, i kam kërku në seancën e kalume kontratat në vepër.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje për të gjithë! Kam një pyetje për drejtorin e inspeksionit, është fjala për parkun e fshatit Salltinë, zotimi i një pjese ose hapësire, të cilën e ka të ndërtuar një qytetar aty, i cili e ka të ndërtuar. Çka zhvillohet aty, çfarë veprimtarie bëhet aty, a ka përgjegjësi komuna aty?

**znj.Zyrafete Rama:** Përshëndetje për të gjithë! Unë sot para jush po e shprehi shqetësimin për fshatin Pozheran, shqetësim ky që e dimë të gjithë. Është fjala për shkollën “Halil Alidema”. E kemi paraqit shumë herë edhe në kuvend, po ashtu edhe në mbledhje të KPF-së. Një ditë më parë në Pozheran këshilli i fshatit, këshilli i shkollës, këshilli i prindërve dhe me gjithë këshilltarët komunal, kryetarit të komunës, nënkryetarit, kryetarit të kuvendit, drejtoreshës së arsimit, të bëjmë një zgjidhje për këta nxënës të shkollës fillore “Halil Alidema” në Pozheran, që vitin e ardhshëm të fillojnë mësimin me orar të plotë. Nuk po kërkoj arsyetim, por zgjidhje për Shtator.

**z.Remzi Salihu:** Përshëndetje për të gjithë! Unë do t’i paraqes dy çështje. E para, është një projekt që është bërë me sa duket para dy viteve në rrugën Viti –Ramnishtë, dhe i cili projekt nuk di a kanë qenë të punësuar nga komuna apo ka qenë donacion. Si do që të jetë, është një projekt i dështuar 95%. Pyetja është: pse 95% e drunjve dekorativ janë tharë, nuk janë funksional. Unë sot pikërisht vetëm njëmbëdhjetë fidane janë vitale, të tjerat janë të thara. A ka dikush ndonjë përgjigje. Pyetja e dytë është për drejtorin e inspeksionit: sa objekte të ndërtimit të lartë janë momentalisht ka ndërtohen ne Komunën e Vitisë, pikërisht në qytetin e Vitisë? Sa inspektime janë bërë dhe a ka tejkalim të normave apo lejeve? A posedojnë leje të posaçme të parapara me ligje këto ndërmarrje apo këto ndërtesa që janë ne punim e sipër.

**z.Nexhat Halili:** Përshëndetje për të gjithë! E kam një pyetje rreth rregullimit të rrugëve në Komunën e Vitisë. Në kuadër të këtyre rrugëve hynë edhe rruga “Ali Muhaxheri” në fshatin Tërstenik, e cila në fazën e parë është asfaltu, edhe pse minimalisht kushte, mirëpo problemi është te pjesa e mbetur, e cila është në gjendje të tmerrshme, sidomos në kohën e reshjeve atmosferike. Kjo rrugë është shumë e nevojshme. Nuk besoj se kjo rrugë ka kosto të lartë, dikun me gjatësi jo më shumë se 300-400 metra. Në kuadër të kësaj rruga “Rexhep Hoti”, e cila rrugë është rregullu një javë para zgjedhjeve të vitit të kalum në zgjedhje lokale, ju kërkoj struktura po edhe ju koleg delegat, hajdi të shihni atë rrugë në çfarë gjendje është e demoluar kaq shumë sa nuk mund me marr me mend. Këtu nuk kam koment brenda gjashtë muajve të demolohet aq shumë ajo rrugë. Pyetja tjetër është, edhe pse dy rastet i potencuan ujësjellësin e pesë fshatrave. Unë deri tash në secilën seancë çështjen e ujësjellësit e kam ngrit, deri tash kurrfarë zgjedhje nuk është bërë. Çka do të merret, çka do të veprohet rreth këtij ujësjellësi. Unë e kuptoj se ndoshta ka obligime financiare të energjisë elektrike, mirëpo ju si struktura të vini t’i vizitoni këto pesë fshatra, të bisedoni me fshatarët dhe të bëni një zgjidhje, te kemi ujë. Në kuadër te kësaj duhet të përfshijmë edhe rregullimin e trotuarit, i cili i lidhë tre fshatra: Trestenikin, Sadovinën e Muhaxherve dhe Salltinën e Epërme. Kur do të filloni, unë po shoh se keni fillu me disa trotuare, edhe pse janë në fazën e parë, por puntë kanë ngecur në disa fshatra tjera. Edhe një pyetje nëse me lejohet: a është bërë një evidencë për kontratat me kohëzgjatje 2-3vjet. Ne jemi dëshmitar të ngritjes së çmimit. Kontratat janë 2 vjeçare dhe 3 vjeçare. Shembull, çmimi i derivateve ka qenë 1 euro fillim vitit 2021 ose 2020, sot diku është 1,60 me tepër. A kanë bërë një evidencë për këto kontrata, sidomos për kontratat për punë edhe kontratat tjera, ku operatorët ekonomik nuk mundën me i përballu çmimet të cilat i kanë pas në kontratë.

**z.Ali Bajrami:** Përshëndetje për të gjithë. Unë kam dy pyetje. Një e kam për drejtorin e bujqësisë, që sektorin e bujqësisë këto ditë rreth aplikimit për subvencione. I kisha përgëzu për punën e palodhshme që kanë mujt me

bo. Është një interesim shumë i madh për aplikim. A është shty afati edhe deri kur, që bujqit e Komunës së Vitisë mos të mbesin pa subvencione? Pyetje tjetër është për drejtorin për kulturë, rini dhe sport. Janë nda subvencionet, komisioni i ka anulë, çka është në pyetje që ka ardh deri te ky anulim. Sa kanë qenë aplikus, sa janë pezullu. E pash vlerësimin me poena, sa është vlera e poenit? Dhe tjetra, sa është vlera e subvencioneve që janë nda.

**z.Durim Sylejmani:** Arsyeja pse sot kam marr fjalën jashtë rendit ditës, është pikërisht një skandal i cili ka ndodhur rrjedhimisht nga Drejtoria e Arsimit muajin Prill të këtij viti. Ky skandal është ndërlidhje me shpalljen e përfituesve të bursave studentore. Fillimisht është shpall një listë e përfituesve dhe më pastaj pas presionit publik për parregullsi gjatë këtij konkursi është anulë kjo shpallje. Kjo tregon më së miri e pranon fajin vet Drejtoria e Arsimit për këtë keqpërdorim. dhe e dyta është për punëtorët e pastrimit këtu ne Viti, të cilët nuk kanë marr paga, dhe kur mediumi lokal e ka pyet kompaninë, se pse nuk i kanë marr pagat ata punëtor. Ndër përgjigjen e Komunës së Vitisë për këtë muaj Komuna e Vitisë ka thënë, se jemi duke pritur një vendim për paga, ndërsa kur është puna me i dhanë tender 2 milion “Pro grup”, këta jo se po presin vendim, po nuk presin kurrfarë vendimi.

**z.Sejdi Emini:** Tani më trotuari në fshatin Goshicë ka fillu, mirëpo në fillim të fshatit familjet Limani janë pa kanalizim. Tash nuk e di ata qysh kanë me bërë zgjidhjen, por është mirë me mëndu që me i lidh me fshatin Gërmovë atë pjesën ku rruga ku fillon në “Lagjen e Muhaxherve| në drejtim të “Lagjes Buzhal”. Po ashtu aty është edhe një rrugë që daton qysh herët, që është mbyll. Është mirë me mëndu me qel, sepse e shpërndan pothuajse 2 km rrugën për me dal te xhamia në Gërmovë. Kam ngrit edhe me herët një kërkesë, që është në interes të qytetarëve të komunës tonë. Shkollën e muzikës, është mirë që këtë proces me shty që në shtator, me pas një paralele që me ju kriju kushte edhe mundësi talentëve të cilët i kemi në komunën tonë.

**Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përhëndetje për kryetarin, ju këshilltarë të nderum! Pyetja e parë e këshilltarëve të cilët tre ishin që e ngritën si çështja e ujit për pesë fshatra. Këshilltari i fundit tha që duhet të bisedohet edhe me fshatrat. Unë po ju njoftoj rrjedhimisht qysh janë tu rrjedh proceset edhe përpjekjet tona. Të nderuar këshilltar, ju e dini që çdo lokalitet e ka të zgjidhet përfaqësuesi i vetë, kryetari i këshillit të fshatit, dhe pardje kam pas një takim me gjithë përfaqësuesit e këtyre lokaliteteve, që konsideroj se gjithëherë kur kam bisedu me këta kam bisedu edhe me banorë, se ata e përfaqësojnë dhe nuk ka ditë që nuk i bëj 3-4 telefonata për çështjen e lëshimit dhe pagesën e rrymës. Nuk ka qenë problem mi shti lokalitetet mi pagu, se ata janë hargju vet, por megjithatë kem insistu me kryetarin, pasi që CDI-ja ka qenë implementuse e projektit, derisa nuk u pranë teknikisht, i bart shpenzimet e rrymës na zotuese, po dhe megjithatë me urdhër të kryetarit unë i kam nënshkru 125 mi euro, ja kam lëshu objektin vetëm për me ardh deri te çështja e mënjanimit të këtyre pengesave të këtyre fshatrave dhe fshatrave të tjerë. Ndodhin nganjëherë disa pengesa, jo nga ana jonë po nga ana e punëkryersit të cilat disa çështje mund me i shtjellu më përpara. Unë besojë dhe shpresoj së shpejti do ta zgjidhim këtë problem dhe banorët e pesë fshatrave do ta kenë ujin nëpër shtëpitë e tyre. Çështjen të cilën e ngriti të semaforit këshilltari do të përgjigjet se është drejtori. Kërkesa për pagesën e gjashtë seancave, masi është e rregullume me udhëzim administrativ që e kam pa unë, ne do ta shqyrtojmë mundësinë së bashku me kryetarin dhe me të vërtetë si do ta vendosemim a do të jen gjashtë seanca do ti mbaj kryetari me kryetarët e këshillit të fshatit, a dot jenë që do ti mbajnë 5-6 takime në lokalitet. Ne do të ulemi dhe do të formojmë atë formulën se si duhet me ditë se parat kur paguhen munden me pas edhe evidencë edhe formë se si është kry. Sërish Tërsteniki e ngriti njëri prej këshilltarëve. Zyrtarisht mund të jetë informacion se, kontrata ju ka kthy drejt që i ka ardh kryetarit, megjithatë mund ndodhë, ne po lutemi që u ka ndërprere kontrata, se ne kemi insistu shumë herë, po urojmë që nëse ka ndodh qashtu, se ne duhet ta përfundojmë sa më shpejtë. Liridona e ngriti çështjen e rrugës. E ki fjalën për “Kongresi i Manastirit”? Unë nuk e di çka nënkupton me investime të dopta, e ki përdor një terminologji, ta kom shenu ashtu qysh ki thanë, megjithatë investime të dopta nuk e di. Besojë që ka menaxher të kontratës ka edhe

organ i cili i mbikëqyrë, por ka edhe komision, prandaj këto duhet me pas parasysh. Dhe pyetjen tjetër që e ka shkru, ke thanë, që ju ki drejtu Drejtorisë së Arsimit, që konsideroj për drejtorin kulturës, rinisë dhe sportit, se ke thanë rreth çështjeve të subvencioneve, por që e kryne është. Të lutem, fillimisht thirrjen e ka bërë drejtori me propozimin e drejtorit. Kryetari i komunës ju e dini së është organi më i lartë ekzekutiv kem bërë thirrje, kanë apliku, kryetari e ka formu komisionin prej pesë vetë, të cilët e ka bërë ndarjen e subvencioneve për 15 vetë thujse rrugës për thirrje. Megjithatë afatin e ankesave e kanë shfrytëzuar të pakënaqur lidhur me komisionin që kanë vepru dhe kemi qenë obligativ, formojmë një komision të ankesave. Komisioni i ankesave, pas shqyrtimit dhe proceduarve të cilat kanë ndjek komisioni shpallët, kanë dal me propozim dhe ka vendos që të anulohet vendimin të cilën e ka marr komisioni i shkallës së parë dhe unë e kam pa dhe serish do të kthehet procedura dhe të bëhet thirrja me siguri së shpejti dot bëhet edhe thirrja dhe do të përfitojnë të gjithë ata që plotësojnë kushtet aty, nuk ka njëanshmëri, për shkak se do të jenë pesë anëtarë dhe ata do të vendosin ashtu dot vijnë pesë komision për ankesa. E ngriti këshilltarja, tha kryetari i komunës ka thanë brenda 4 muje pas zgjedhjeve dot rregulloj çështjen e ujit. Kjo e konsideroj se është e pa vërtet, se a ka thanë do të ketë qasje dhe do ta rregulloj brenda afatit, brenda mandatit po. Unë e kam bindjen se do ta rregulloj. E ki thanë se ju po bëni shpenzime të lluksit. E nderuar këshilltare, po të njoftoj se, shpenzime të lluksit në Komunën e Vitisë, nëse ti konsideron se shpenzimet e lluksit janë kur të vinë ambasadorët, edhe me dal ne drekë, ki gabu shumë, nëse ki thanë shpenzime të lluksit janë kur vinë shoqëritë mat ndryshme evropiane dhe botërore dhe ti i quan shpenzime të lluksit, prandaj tërhiqesh nga ato që po i thu, se unë nuk po shoh lluks, po po shoh punë të ngritje të kulturës njohje të Vitisë nga ana e ambasadorëve të ndryshëm. Prandaj shpenzime të lluksit vetëm mundesh me e imagjinu, ndërsa në Komunën e Vitisë nuk ka. Drejtori sa i përket fermerëve, do t'i merr përgjigjet. Ka pas pyetje edhe rreth seancave, ku besoj se kem me përfundu shpejt dhe do të jem drejtpërdrejt, të jepen performancë maksimale. Do të na lem këtu te replika që tha kam replikë me nënkryetarin dhe drejtorin. Ti replikë mundesh me pas, unë gjithherë reagoj aty ku konsideroj se jam obligativ dhe për shkak të provojës. Nëse na mendojmë se bëjmë pyetje dhe përgjigjemi vetë, nuk ki nevojë me pyet kurrë dhe kjo nëse nuk ka ndodhë te këshilltarja të cilën ti reagoje, zotëri Jakupi, e ki shumë gabim, se ajo edhe e ngritke edhe u përgjigjke. Kur thu i kam dy pyetje, unë nuk reagoja tek ti, se ki ngrit çështjen e parkut të Sllatinës ke dëshmu se është një ozurpim, është çështje drejtorive tash mu marr, po nëse thu ti qeshtu është dhe fillon ti me zbatu, atëherë ski çka pyet, se po e dishe pikërisht për këto kam reagu, se besoj se është injorim edhe për kolegët, por është edhe për ekzekutivin, se në administratë edhe në kuvend përveç efikasitetit ke thanë se edhe efektiviteti, prandaj unë konsideroj se këto duhet t'i harmonizojmë dhe të ecim përpara.

**Sokol Haliti Kryetar i komunës:** Përshëndetje kryesues, qeveri komunale dhe shumë të respektuar këshilltarë komunal, media të shkrueme, elektronike, përfaqësues të zyrave që jeni këtu, OSBE dhe prezent të tjerë që janë këtu! Me një agjendë të punës, e cila është e propozume nga ana e sektorëve, e aprovume në bordin komunal dhe e shqyrtume me Komitetin për Politikë dhe Financa, ku marrin pjesë gjithë grupi parlamentar. Si ish kryesuesit dhe kryesuesi aktual, ju kam thanë se kryetar komune dhe si njeri që kam punë edhe me herët, kam qenë edhe këshilltar komunal, edhe pjesëtar i qeverisë komunale, tash edhe kryetar, se kjo pikë të ndryshme duhet me kalu e fundit për me marr përparësi edhe rëndësinë e rendit të ditës së mirëfilltë, me propozim vendim në mënyrë që në pyetjet dhe përgjigjet rregullarisht mi bërë në fund, me pas mundësinë mu përgjigj edhe në seancat. Këtu ka pyetje edhe për zyrat e caktume, edhe temave për ingjiniera, se kur thuani kjo çështje është e gjithëve, unë e përkrah se është e gjithëve. Duhet të kem parasysh dukuri devijonte, negative i luftojmë të gjithë bashkë, i lufton edhe qeveria komunale, e cila po vlerësohet. Ty këshilltar po të qeshet, po je frik që ke ardh dhe je pa provoj, prandaj po bën gabime të tilla, të cilat unë po të thamë që nuk kanë me kalu vetëm në kuvend, po ti do ta fitosh një padi të mirë për shkak sjelljeve vërtet abnormale, vërtet jo etike, jo institucionale. Dëgjo, veç pak, je djalë i ri edhe shiko kur akuozosh njerëzit për çështje të tilla, duhet me ditë se pason padia, se herën e kalume të kam kalu për shkak se të ka kalu kryesuesi i kuvendit, i cili të ka leju me kërk falje edhe grupi yt

parlamentar, i cili ka leju që, një këshilltar i kësaj përmbamje me përdor fjalor të tillë çfarë po përdor ti herën e parë që seanca është e inçizumë, prandaj këtë sjellje dhe këtë fjalor heke prej rendit ditës, prandaj këtë fjalor përmirësoje, se është e fundit, është shumë i rënd ai kualifikim, sikur që ka qenë kualifikimi që e ki krahasu me dikon që faktikisht mundesh veç ti me qen i lehtë jo unë. Nëse je i tillë edhe ki fjalor të rrugës, mos e bon ne kuvend, se parti politike në Viti në cilat kanë kontribu edhe unë njëri prej pak kontribuuesve, e kemi ruajt pretekstin edhe fjalorin dhe nuk i kemi quajt njerëzit të tillë. Prandaj arsyeja e fjalorit të cilin unë e përdora më herët, se kryesuesi nuk ia tërheki vërejtjen, është e dyta herë që unë dëgjova vet, ti duhet me pas pak edukatë, ki kujdes, mos e përsërit. Unë po ja nisi prej përgjigjes, atëherë te pyetjet e tua, Sokol Haliti, bashkë me kuvendin komunal dhe me qeveri komunale është angazhu që atë grykën e moravës të cilën e kam pas në program në dy mandate me zhvillu dhe tu e arrit atë gryk dhe shikone, unë po të premtoj me zhvillu, qeveria jote po e bllokun rrugën e mjakut, po e bllokun rrugën e Stubllës së Epërme me Goden. Në buxhetin e vitit kalum ka qenë dhe këtë vit naj ka hekë dhe është shkelje ligjore. Unë kam punë me transparencë të plotë, me llogaridhënie që sot na ka ardh raporti e auditorit gjeneral, prandaj merrne raportin e auditorit, nëse aty ka shkelje të rrezikshme, unë që ku jam. Sot ka ardh raporti zyrtar, i kallëzova edhe pjesës së qeverisë edhe pjesës së grupit parlamentar, prandaj këtë kuptim duhet me pas na kujdes në fjalor. Një pjesë te tema që ngritën këshilltarët, mu më pëlqej shumë, shumica e këshilltarëve ngritën tema të punës, pa marr parasysh a janë tema të kësaj drejtorie ose asaj drejtorie, a janë të atij sektori, ja vlen me diskutu, nuk është temë tabu. Por mllaki, e kanë diskutu këshilltarët, e dinë që është nën. Mllakin kemi mujt me përmirësu aq sa kemi pasur kompetencë, herë mundësi operacione teknike, lëvizëse, mirë që mos me prek te pronat për shkak se nuk guxon me ndërhy komuna te prona, se është ligji i prokurisë, juristat kanë provoj në zyrën ligjore që kanë punu, prandaj ne kaq e kemi pas, të tjerat dukuri devijante nuk i lufton, në politik i zgjedh organet e drejtësisë, organet e rendit, por ne mund të ngritmi çështje të tilla në interes të qytetarëve, që dukuri devijante me i luftu, prandaj ne bashkë këtë komunë për ata të pronat duhet me pas kujdes. Ne e punojmë, e rregullojmë, e ndreqmi mos me lan djerrinë, por me bërë esencialisht estetike dhe funksionale që më shfrytëzu qytetarët. Kërkesën për ndërrimin e trotuarit. Ju e dini që e kemi bërë edhe në kuvend, prandaj kuvendi e ka vendos, por nuk është vend vendimmarrës, se akte nënligjore karshi ligjeve nuk kam fuqi. Shkolla fillore “Halil Alidema” është një proces tjetër që sërish jemi bashkë, mu nuk më pëlqejnë ato aspektet tjera politike që po insistohet në anën tjetër, po bllokohet, politikat e veçanta po mundet mu përzi aty besa edhe deputet, ndërsa lëvizje nuk ka, ku bllokimet nga ana e ministrisë e cila edhe financon edhe e mbikëqyrë, nuk kena mbikëqyrje ne komuna, nuk është e pakt me thanë se mbase 76 herë kam qenë si kryetar i komunës para shkollës “Halil Alidema”, për me kërku edhe me qu përpara. Ka pas zëvendësministra i kanë pru aty, ministrat, takimet e fundit që i kemi zhvillu. Por unë jam me qytetarët e Pozheranit, jam me kuvendin, jam me juve këshilltar, jena gjithë bashkë qeveria, Drejtoria e Arsimit, që me funksionalizu ma shpejtë. Ju e dini që një komision profesional e kanë votu, që ia kem respektu mundësinë e përparimit në shkollën e vjetër, prandaj ne kemi bërë një veprim tjetër. Normalisht që nuk na shkon përshtatje, se kemi më shumë ndërrime me nxënës atje te shkolla vjetër, prandaj neve na vyen, qysh na vyen Gërlica shumë shpejt mu bo. Ju e dini çka ka thënë për Gërlicë, ne duhet mu kanë krejt bashkë, prandaj këto situata deputeti po e ndreqka e unë çka pasna tek këto që unë përmenda, atë situatë. Kjo nuk është problemi ta marrim kush pe merr përgjegjësinë, kush pe ndreq, koment juridik nuk është tu më vye, as mu përsipër, se edhe unë ku të ndreqet edhe unë du me thanë që kjo shkollë u ndreq bashkë taksa pagust parët nivel qendror dhe nivel lokal janë bashkë si të njëjtë, si stadiumi. Ju e dini për stadium si ka rrjedh situata, por unë e kam pas problematikën e atij stadiumi, e kemi përballu këtë situatë për shkak të së mirës, për shkak se në afat të gjatë koha e kallxon. Dhe ne fund kur ta përfundojmë stadiumin, që është afër, atëherë ne dalim se ja kem arrit. Edhe te shkolla kena me ja arrit, por është vonu, por ja vlen për me prit, tash a ka probleme tjera politike atje që ka thanë Iliri, unë nuk kam informacione zyrtare. Mu si komunë së paku më ka informu ministria me duhet informu, ne jemi me jurispodencë të regulltë me mbikëqyrjen prej ministrisë. Atje ka probleme tjera që mundem me thanë është politik. Nuk është mirë problemet politike siç kanë qenë sot janë me pas edhe me ndiku. Domethënë që me ngandalsu. Shkolla e muzikës është imperativ. Unë e kam përmend edhe gjatë fushatës, jo veç unë e kanë përmend, edhe kandidatë tjerë e kanë përmend, edhe Bekimi. Kemi me bërë bashkë, kemi me bërë gjithë. Unë besoj që një paralele kena me bo shpejt, sikur që e kemi vonuar edhe për aspektet tjera, edhe për sallën e teatrit. Trotuari ka fillu në Goshicë, mirë që ka fillu, ka fillu në Fshat të Ri, ka fillu në Zhiti, ka fillu në Bllancë, ka fillu në Rdivojcë, Devajë, ka fillu në Kabash, rrethrotullimi te xhamia

atje ka me fillu, trotuari Nexhat edhe në Sllatinë, ka me fillu edhe rruga gjysma tjetër dhe atë tjerat i kemi rregullu. Ju kam vërejt disave po boni kritika të shumta. Tash unë ty pot kritikoj. Kohen kur ti ke punu në komunë, s'keni pas ndreq kurgjo, e tash masi kam ardh unë e kam lidhë me Sadovinë Cerkezve, e kam lidhë me Komogllavë e kam bo asfaltin e ri, ti s'po e përmend asfaltin e ri prej Slltinës anej, se e kam fushën, është ba shkolla aty, është përruru që ka fillu ma herët, jo në kohë tonë, mbasi kam ardh unë e kam pru ujin, është vendimi është për pesë fshatra është nisë me herët kohën e Nexhës, por vendimi ka mbet financiar, pa pagu. Unë i kam pagu, Me këto ka qenë, u nëshkru qysh nëshkru tri faqe, ku kanë qenë financues komuna edhe "Hidromorava". Janë dal me mbikëqyrje, unë i kam kry obligimet e komunës të cilat kanë mbet si vazhdimësi, tash obligimet tjera janë nga "Hidromorava", e tash nëse dojmë me bisedu qysh me tejkalu këtë situatë, atëherë unë që ku jam, unë po thamë se kanë marr përsipër me pagu. A është në rregull, këshilltarët duhet mu ulë me marr me mbikëqyrje edhe duhet me pagu atë që hargjojnë me fakturë, përndryshe na marrim, na majna këto zgjedhje të përkohshme. Tash na kuvendi marrim 5000 mijë euro shembull, po në kohë të zgjedhjes prapë na e marrim, prandaj hajde folim në parim për çështjet që dojmë me i qu përpara, nëse dojmë me fitu poena politik, unë tu e planifiku trotuarin, tu e planifiku ujin, tu e planifiku rrugën te Muhaxhert, e ti me marr poena politik, këshilltar, ki fitu ama ki fitu një herë, se unë, se pa kry punën e ti me fitu. Jem fitus, edhe moral edhe institucional, ndryshe nuk shkon. Qe shembull me këshilltarin, jo është këtu prezent, po të Fshatit të Ri, jena marr vesh shumë lehtë, se problematikat dojmë mu zgjeru me arrit. Na planifikojmë si duhet, unë jam bashkëbisedim me këshilltarët komunal, për secilin fshatë, secilën lagje, por me argumente. Nëse mundesh si ekonomist i mirë qe je Nexhat, që shumë të çmojë, atëherë paguaj, atëherë na duhet mu kanë pak ma institucion, jo veç me gjuajt, duhet me i marr përgjegjësitë secili të vetat. Në këtë rast komuna i ka kry përgjegjësitë e veta, shpenzimet e veta, na tash vet i kryejmë, na tash si qytetar ose si këshill ose fshatë këto, e për kryetarët e fshatrave, se më në fund edhe kryetari përafërsisht poenave, se me fol të drejtën nganjëherë mund mu zbehë përkrahja politike, por zbehet shumë përkohësisht, se e ardhmja, domethënë që ke pas të drejtë. Te stadiumi shembull, çfarë propagande negative. Unë faktikisht e kisha marr barrën e përgjegjësisë krejt, zhveshtorët ma të mira, veç Prishtina që i ka ma të mira. Te shkolla gjithashtu e Pozheranit, kryetari i fshatit qenka këtu, as projekt s'ka pas, krejt me projekt, me komision, me krejt, fillimisht. Tash ka mri ku kena mri, aty do të jemi bashkë, kryetari mos me qenë e deputeti me ardh mi marr poenat aty për shkollën e Pozheranit, takim, e mu fry aty në Pozheran, jo ashtu se e dëmtoni veten edhe politikisht, ashtu nuk bën mirë. Unë po flas në parim, edhe po kryetari me deputetin po. Drunjte dekorativ që janë tha, është përgjegjësi me pa përgjegjësinë e parë, ne ti kthen për çdo dëmë për një dëmë. Përgjegjësia është individuale, ne ta merr shumë herë ju kam thënë, secili në zyre ne të vjen. Drunjte dekorativ, do të thotë Vitia ka mbjell dhe ka me mbjell. Unë e di qe demolim ka edhe individual edhe prej qytetarëve, përgjegjësinë e kanë, dhe si qeveri muj me ta dhanë përgjigjen. Unë i dërgoj, ti bi në kuvend, drunjte kanë mu mbjell, gjelbërim kanë mu mbjell, ambienti ka mu kriju për një Viti më të mirë, gjelbërore, me drunjë, me ndriçim, me gjitha, kemi me vazhdu, e kundërshtove apo se kundërshtove. Hera e parë që po e thamë në kuvend, diversione që i kanë thy dritat krejt rend shëtitores, i di këto, por ato sende i kena kalu me delikates, duhet me i thanë i ka edhe raportin edhe policia, aty ka qene tendenca me dëmtu komunën e vetë. Nuk mundet me shku aq shumë opozitarizmi me dëmtu vendin e vetë, ambientin e vetë, me thy ulëse, ndriçimin, me i thy rend dritat. Ka me vazhdu shëtitoret, hapësirat gjelbëruese, ulëset, shportat, kanë me vazhdu ndriçimet edhe më të mira me i bo, parqet kanë me vazhdu, e tjera. Unë ju ftoj vetëm për bashkëpunim. Pytjev, përgjigjen e kësaj pikës, unë po ju kallëzoj edhe këtë seancë. Në seancën tjetër unë jam propozues me kalu të ndryshme, ku duhet dëgjoni e ju jeni te anashkalu qëllimin e funksionimit të kuvendit. Ju pyetjet i boni, përgjigjet ia kthejnë drejtorat krejt me rend, unë disa aspekte që me të vërtet merr brezë çdo sjellje, unë dola që nuk bën. Edhe tjetra, unë kisha një agjendë që e luta nënkryetarin me qenë këtu prezent, por erdha se mu kanë i iki debatit. Profesorë, nuk i iki debatit, se unë e mendoj këtë progres, unë e mendoj me punu bashkë. Unë e di që Vitia është e krejt neve, përgjegjësia është individuale, edhe me pas përgjegjësinë nëse ti s'mund me hekë, prandaj mos u mundo kot. Për Tërstenik rregullimi i trotuarit, e di që e din, e kena disku atëherë çështjen e formimit të trotuarit në Tërstenik me ditë, prej në formim kemi qenë bashkë, qe ku janë këshilltarët e VV-së dhe PDK-së dhe të LDK-së, unë ju kam kallxu këshilltarëve, lirish bëhemi bashkë. Rruga "Muhaxheri" është i planifikum. Te subvencionet është drejtori, drejtoritë veç e veç ne të përgjigjen secili. Kanalizimi për disa familje, secilin fshatë i kemi, ju e dini problematikën që ka qenë profesionale rreth atij kanalizimi, se s'ka dal as në Goshicë as në Gërmovë, prandaj

duhet një zgjidhje tjetër, e kemi diskutu e kemi shqyrtu inxhinjerat krejtësisht, është çështje profesionale, jo e vullnetit, as mungesë buxhetit, nuk është ajo çështje formale e asaj, nuk është lagje familje janë një prej çështjeve vetëm inxhinjerat kur ta gjejnë zgjidhjen një vit e diçka deri kanë gjetë zgjidhjen se ka pas problem. Domethënë është problemi i ramjës, problemi është krejt sensibilitetit projekti tash duhet me pas sukses, se vetëm po bëhet investime. Kjo që tha Jakupi, po keqpërdoret Millaki, mendoj që është individuale, nëse është rast i izolium, për pesë fshatrat, unë fola edhe për fshatra të tjerë, si kuvend edhe si komunë jena tu fol kontakte me kryetarin. Kur tha jemi tu e ba maksimumin, ju e dini marrëveshjen, kontratat, jam tu kërku edhe 125 mijë euro. Do të thotë Stubllës, këtë pjesën tjetër, edhe fazës tjetër që ne i kemi arrit mi buxhetu edhe me kry marrëveshjen, edhe unë shpresoj që kemi qenë efektiv sivjet, po të shohim nëse na duhet presioni duhet me bo qeveri-kuvend bashkë, se për shkak se ky problem ka shku shumë ngadal. Ju e dini koleg, nuk u miratu në kuvend, na ka shku parlamenti nuk e ka miratu Vitisë, nuk e ka qitë. Ne duhet me insistu me qitë edhe të Vitisë, edhe deputetët duhet mu kanë me neve bashkë. Këto domethënë probleme janë sfida, sikur zona ekonomike që është sfida, e kanë nal tash, e keni pa tash ju kur thoni problemi që ka. Ju këshilltarët komunal nuk po i thoni qeverisë pse murren zonën ekonomike, e pse nuk e murren qeveria e kalume.

**z.Naim Pira, drejtor:** Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët dhe për të gjithë të pranishmit! U prashtrun disa pyetje, po filloj nga fundi. Zotëri Haxhiu, i parashtruat disa pyetje karakterit të njëjtë dhe të aplikimit për subvencione. Mund t'ju them se, nga hapja publike jem organizu si Drejtori e Bujqësisë dhe kemi bërë konsiderojmë punë të mirë. Janë dikun 1000 sigurisht që kanë apliku për subvencione, të cilat priten nga niveli qendror. Nuk kemi pas asnjë problem, edhe pse ka qenë e koklavitur kjo çështja e aplikimit për shkak se jem mes listave të fletës posedues dhe ishte shtu apetiti i disa bujqve, po e them ne thojza, për me zapu pronat e tjerëve. Po si do qoftë ne kemi kalu mirë, me çështje tjera merren organet tjera. Afati është shty edhe për një javë ditë, deri me të parin kanë mundësi bujqit me apliku. Po i them edhe një herë, problemet e natyrave të ndryshme ku kemi pas, veç duhet me i falënderu vërtet punëtorët që kanë bërë një punë të jashtëzakonshme dhe të shkëlqyeshme, edhe pse pyetjen që e parashtraj zonja Majlind tha, shpenzime të lluksit. Po ju thamë që, as petikesh në Drejtori të Bujqësisë nuk kanë leju dhe shpesh i kemi mbështet ata punëtorë që kanë punu edhe prej qefit me ujë edhe me kafe nëse ka pas nevojë. Pyetjen tjetër të cila e parashtraj zonja Majlind, rreth mënjanimit të bujqve dhe fermerëve, dhe mënjanim po mendoj termin. Për mu është e pakuptimtë është e pakjart, sepse ne si Drejtori e Bujqësisë, momentin që kemi marr punën jemi organizu dhe kemi bërë thirrje, deri tash kemi bërë thirrje për me subvencionu bujqit e Komunë së Vitisë, e cila për shkak problemeve normale OQPS dhe ankesat, kjo çështje është shty dhe du me than kështu haptazi para mediave të informimit, jam unë i kënaqur që s'ka kalu kjo çështje, se e keni pa ju që bujqit janë ballafaqu me probleme të ndryshme të marrjes së misrit, për shkak se niveli qendror me inspektorët nuk e di sa kanë dal ne teren për pjekje. Minimumin e parë që kanë qenë dhe bujqit janë ballafaqu dhe i kanë ngel, analizone sikur të kishe dështu një projekt i tillë i Komunës së Vitisë, cilët kishin me qenë reagimet e qytetarëve për juve si këshilltar. Kemi bërë thirrjen edhe për subvencionimin edhe parcela, natyrisht kanë përfitu 50 fermer për përfitimin shalqirit, kryesisht ka qenë pjesa ka Skifteraj dhe një pjesë e fshatrave tjerë. Projektin tonë njëvjeçarë, kemi edhe projekte tjera që do ti shiheni shumë shpejt. Dhe një pyetje tjetër e parashtruat, pyetjen e cila zonja Majlinda në Kuvendin e Republikës Kosovës dje po ju thamë se ne vitin 2021 ka qenë një masterplan i nënshkruar nga ish kryeministri zotëri Hoti, që vlere e ati projekti ka qenë 600 milion euro. Për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës do të ndërtoftshin sistemin e ri, kryetari Agimi ka nënshkru një marrëveshje me ish kryeministrin Isa Mustafa për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit në Komunën e Vitisë dhe me marrjen e pushtetit aktualisht ka të cilët Lëvizja Vetëvendosje në mënyrë të njëanshme e kanë shkëputur një marrëveshje të tillë, e cila është nënshkru nga ana e zotit Mustafa dhe Agimi, më vonë mbas marrjes së detyrës, dikun në shkurt të këtij viti kemi pas një takim me ministrin dhe prezent ka qenë edhe sekretari i ministrisë. Kam ngritur një shqetësim tillë dhe kam bërë një pyetje të tillë dhe na kanë thanë se kësaj here vetëm me sistemet aktuale të cilat janë në Kosovë dhe për çudi neve me njëzet e nëntë Prill na vjen një shkresë, e kam



këtu të protokolumet nga ana e ministrisë dhe na japin afat deri me 20 Maj. Analizone, këtij muaji që me përgatitë me projektet e detajuar në mënyrë që të konkurrojmë për ministri dhe do t'i analizu, se Maji ka qenë muaji i cili pothuajse se gjysma e mujit ka shku me festa të ndryshme dhe analizone për 12 ditë punu se çfarë projekte mund të bëjsh. Kjo ka qenë sa me hek përgjegjësi. Ne si Drejtori e Bujqësisë, në bashkëpunim me kryetarin dhe organet e tjera, jemi zotu se do ta bëjmë një projekt vërtet ashtu çfarë të dojmë dhe vërtet dot konkurrojmë në ministri dhe te shohim cila dot jetë përgjigja e tyre.

**z.Adnan Imeri drejtor:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Për drejtorin e inspektionit u parashtrun dy pyetje, njëra nga Jakup Demir këshilltari, për parkun, një park jashtëzakonisht i rëndësishëm për banorët e fshatit Sllatinë dhe për gjithë Komunën e Vitisë. Në fakt se te gjitha i përcolli kryetari i komunës zotëri Sokol Haliti, që kjo adekuate, mirëpo fatkeqësisht ajo problematikë të cilën e paraqiti Jakupi, na kemi hasë do të thotë në atë problematik dhe dot thotë jemi te indentifiku lokacionin se a është në pronë private apo është në pronë që mundë me na qu edhe prej AKP-së dhe varësisht do të thotë prej si gjendet dhe do ti marrim hapat ligjorë dhe se kem të drejt me vepru, ndërsa sa për çështjen e asaj kafshës që paraqitet si opsion i rrezikshëm, do t'i i njoftojmë agjensin e ushqimit. Pyetja e dytë ka të bëj me këshilltarin zotëri Remzi Salihun, pyetja ishte me sa kuptova sa objekte të ndërtimit të larta janë duke u ndërtuar në Komunën e Vitisë, sigurisht e ka fjalën në zonën e ndërtimit brenda territorit të Komunës së Vitisë. Domethënë objektet të cilat janë inspektuar nga inspektori i ndërtimit që kanë filluar, domethënë në vitet paraprake 2019-2020 dhe 2021 po që janë inspektuar domethënë edhe vitin 2022, ndërsa në objektet që kanë filluar shembull që i ka inspektu inspektori ketë vite 2022, dot thotë për momentin kemi një dhe një e kemi në inspektim tjetër te rruga “Dëshmorët e Kombit”. Vlenë të ceket se përmbaruesit dhe veprimi ne kundërshtim me lejen ndërtimore dhe ligji mbi ndërtim, inspektori i ndërtimit masa ligjore siç janë pezullim ndërtimit dhe ndërprerë lejen e ndërtimit në rast se kemi shkelje masave të inspektorit të ndërtimit, shkelje të vendimit apo heqjen. Në këtë rast të shiritit te cilën e vendos inspektori, atëherë do të marrim masa shtesë siç janë: pezullimi penal i cili dorëzohet në prokuri themelore ne Gjilan kundër investitorit, i cili kryen këto veprime antiligjore.

**z.Visiar Demiri, drejtor:** Përshëndetje për të gjithë! Një pyetje që e bëri për planin zhvillimor komunal, drafti final të planit zhvillimor e kemi dërgu në ministri. Po presim përgjigje deri javën e ardhshme që të na lejohet ku në shërbim të drejtë dhe me vazhdu me procedurat tjera. Besoj se jemi në metrat e fundit mu hartosë plani zhvillimor komunal.

**znj.Liridona Bisilimi:** Atëherë kisha dashtë një replikë të shkurt me nënkryetarin, tek çështja rruga “Brigada 173”. Nënkryetari tha se nuk po e kupton termin investime te dobëta për banorët e kësaj rruge të cilat unë me plotë kuptimin e fjalës do i kisha quajtur edhe të dëmshme me investime të doptë nga banorët, nënkuptojmë asfalti që është shtruar mbi asfalt trotuari paraprak ka qenë i cilësisë më të mirë se ky që është. Tash ndriçimi publik rrallëherë shumë pak është funksional si dhe nga baraka e deri tek fillimi këtu ka mungesë të kanalizimit. Domethënë kjo ka qenë. Pyetja, më vete pse ka mungesë të investimeve të banorët e kësaj lagje, për shkak se këta hynë në kategorinë e tatim paguesve me të rregullt. Tek pyetja që thash për drejtorin e arsimit, por paske keqkuptuar, thash e kam e një pyetje për drejtoreshën e arsimit, e cila ka munguar ne seancën e kaluar, e cila po mungon prapë, po shpresoj që kjo pyetje qe e kam bërë të më ofroj përmes email zyrtar, ndërsa tek pyetja e tretë për drejtorin për kulturë, rini dhe sport, përgjigja që ma dhe ti dhe ne rastin ne fjalë po shpresoj se të jetë ashtu siç e keni thënë.

**z.Hasan Haliu, nënkryetar i komunës:** Këshilltare, po me vjen mirë që po tenton, po tash nuk po e di ti çka ke nënkuptu me investime dopta, se krejt qytetarët nuk janë inxhiniera, as ti nuk je, as unë, atëherë të lutem se konsideroj jetojmë në shekullin 21 dhe në shekullin 21 duhet të plotësojmë profesionalizmin. Unë jam i thirrur dhe i besu profesionalizmit dhe çdo raport tyre të cilën e japë e marr si të pranueshme dhe nuk shkoj me i pyet

njerëzit të cilët mujn me qenë militant të partisë, të cilët frymëzohen prej tyre, po unë nuk bëj asi dallime. Aspektin profesional duhet ta presim, bëhet pranimi teknik, e përcjell inxhinieri. Tjetra, kultura po thonë, shpresoj atëherë ti koke e dyshimtë, kur je e dyshimtë kurrë mos pyet. Unë kur dyshoj diçka në ty, nuk pyes se e kam atë bindjen time dhe vazhdoj me atë bindjen time. Unë pyes kur besojë se përgjegjësia ndaj institucionit duhet me qenë përgjegjësi të cilën ta obligon ligji dhe e merr përgjigjen gjithherë. Maje në mend, ti kur tem pyetësh duhet mem besu, nuk me beson kurrë mos me pyet, për ndryshe i ki dokumentacionin. Unë nuk e kam pa edhe qasjen që e bën, në qasje dokumentet publike te pyetjen e fundit unë nuk jam me të injoru, po e lyp, thu bima kontratën të cilën e keni. Kur e din mirë, më mirë se unë, se pushteti qendror e bën krejt e lidhë kontratën e obligo me shku me marr. Kam pas problem ti e din fort mirë kur ski çka bon sillesh hajde të thamë diçka.

**znj.Majlinda Shabani:** Shumë interesant, se në kuvend veç pyetje përgjigje duhet edhe bashkëpunim. Nuk është që duhet kështu, që po e shoh si të kryme e bashkëpunimit, po du mu nis prej nënkryetarit kur e përmendi me lavdu komunën për punët e mira që janë bërë, po du me i thanë kryetarit që mundesh me u lavdu si komunë në moment që ki projekte edhe ki një stabilitet në mënyrë në qëndrueshmëria e projekteve, mundësh mu lavdu kur zgjedhën problemet të nevojave bazike dhe sociale, mundesh mu lavdu kur investimet kanë jetëgjatësi shumë ma të gjatë se sa një vit, e mundësh me thanë kur marrin këtë pikë, mundesh me u lavdu si komunë që me u bo realisht një zhvillim shumë të mirë. Po du me kalu te drejtori i bujqësisë, nuk e kuptoj fjalën mënjanim, muj me të thanë prej anës profesionale, por edhe prej anës si këshilltare komunale të njëjtën kohë nuk e ki kuptu fjalën, por prapë se prapë e përdore. Mënjanimi i punës domethënë kur ti si drejtor në momentin kur është koha e mbjelljeve, se edhe kjo është kohë e caktume domethënë është me i përkrah fermerët edhe në sezon të Dimrit, por e dimë që Dimrit të mbjella nuk kemi, kështu që është një farë kohe që duhet me u përkrah fermerët. Ti si drejtor të paktën në kohen e të mbjellave nuk është kryetari në teren me pa punën se qysh po bëhet. Me pa se në çfarë vështirësi hasim ata. Nëse kem has te problemi subvencionimit të grurit, këtë rast të misrit, ke mujt me bë kërkesë edhe ke mujt mu ba ndihmës edhe ne mënyra tjera. Nëse do mundemi me pa, se mundemi me ba ndihmës me subvencion të lehta, artificial. Gjithashtu si komunë ke mujt me nda një fond në këtë rast ish bo subvencionimi. Gjithashtu edhe te puna e ujësjellësit i cili ka qenë projekt. E dimë që zakonisht këto arsytetime prej anës së komunës, për shkak të afateve kohore. Po du me thanë që pak u dashtë kryetari mos me akuzu ministrin që është bo anulimi, për shkak se aty ka pas procedura, obligime të cilat komuna nuk i ka përmbush. E dimë që si komunë kemi inxhinier të mjaftueshëm, që muj me bo këtë projekt. Realisht është dhëmbshmëri nëse Komuna e Vitisë, nuk arrin me bo një projekt e pe marrim shembull, çka nëse dojmë me pru vizitor të huaj, çka kemi na me prezentu si Komunës e Vitisë, uroj që komuna e Vitisë dot me pas inxhinier duhet me pas agronom shumë të zotë që të paktën një projekt kishin mujt me ralizu e jo me arsyetu me kultura kohore të cilat për mendimin tim nuk qëndrojnë.

**Sokol Haliti Kryetar i komunës:** Është e pakuptimtë hala pa hi në rend ditës me zhvillu debate. Ksisoji nuk e diku e keni pa ju interpretim institucional. Këtu hala s’jem në rend ditës këshilltar komunal, rend të ditës duhet me hi tani me zhvillu debat për pika. Tjetra, për projekt të Ministrisë së Bujqësisë, është e vërtet e pakuptueshme me më kallëzu mu që kom punu në Ministri të Bujqësisë edhe bash në atë departament me um tregu mu këshilltare ti për projekt a plotësohet e drejta profesionale me projekt. Ne qysh kemi nënshkru memorandumin pa e plotësua të drejtën formale, ne kemi arrit me kërkesë me projekt debat me lokacione, me hartë zonale me nënshkru me mirëkuptim ministri i bujqësisë. S’ka nënshkru me memorandum për sistem të lëvizjes në fshatin Skifteraj, me kanale të hapura prej lumit “Letnica” që derdhet në lumin “Morava”. Prandaj kujt po i kallëzoni qe praktikisht, formalojuridikisht e di më mirë se ti atë çështje. Tjetra, po i kallëzon drejtorit për çështjen e të mbjellave. Drejtorja e Bujqësisë ka mjaft profesionist të lamiave që nuk i ka as nivel qendror. Planifikimi i të mbjellave atje bëhet, prandaj kanë punu. Buxheti është i planifikum paraprakisht, shiko ti po flet

për komuna tjera, për të Ferizajt që i ka gjysmë milion euro. Prishtina i ka një milion euro mujor, ti i ki një milion euro vjetor. Shembull Prishtina ka ma shumë ama po thamë, prandaj bone krahasimin, planifikimin domethënë bëhet i buxhetit në Shtator, kur miratohet buxheti, dhe atë buxhet me zëra buxhetor e shpërndajmë, e implementon gjatë vitit fiskal. Viti fiskal dihet qysh shkon, sa është, prandaj në këtë kuptim ka me pas sezone, planifikime. Nëse shembull ka dështu një segment, po lidhja hala nuk ka dështu, çka nevojitet profesionalizëm edhe shtytje përpara edhe ajo buxhetit konturat vetanake për subvencione aty ku kena të drejta ilegale, legjitime, juridike dhe financiare. Prandaj, në këtë kuptim, ndërsa ana tjetër po më dhemb shumë dhe tepër si njeri, të bon mu ndi i fyemë jo vetëm si kryetar, po e mbroni një kuadër i cili ta ka ndalu projektin crucial këtu, që ki pas histori në Skifteraj. Nuk është me rëndësi cilin vend, po e mbroni edhe ju thash cila është karriga e kësaj qeverie që keni qu politika atje me anulu projektin, me qëllim, me tendencë dhe kjo është degraduese dhe qytetarët e Vitisë nuk duhet me duru. Drejtoreshën e arsimit që e pyeti që shiko projektin. Qeveria jote e ka marr, u kanë në buxhet, qele telefonin shikoje u kanë buxhet vitit të kalum, Qershor, dje u procedu, janë udhëheqë procedurat për gjithë fituesit, zotimin se kanë lëshu e kanë aprovu, e kanë anulu Gërlicen, a e qiti Gërlicen, prandaj nuk keni guxim me ja thanë, se ti e ki ndalu.

**z.Illir Zuka:** Këshilli i fshati, bashkë me drejtoreshën kemi prit tri javë ditë me ja kthy një përgjigje, që me na taku ministri, prapë na ka prit këshilltari, zëvendësministri e na e dimë fuqinë e tij, e ne kemi nevojë mu taku me ministrin, sepse fuqia e tij është më e madhe.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendi:** Për mu kry shkolla, duhet me qenë krejt së bashku, njëzëri duhet me qenë te koordinuar në mënyrë institucionale, duhet mu koordinu me ministri.

**z.Jakup Demiri:** Kryesues, pajtohem që te jemi së bashku të gjithë e hecim së bashku. Kryetari e ka pas në zyre punëkërkesin e shkollës. Unë e di që ka qenë, ndoshta jam gabim, ama e di që ka qenë në zyre pune. Kryesuesi që tre muaj ren ju thamë për ndriçim publik në Smirë qe po kallen dritat gjate ditës, ende nuk keni ndërmarr asgjë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendi:** Nëse doni me diskutu për ndriçim publik, e bëjmë një pikë të rendit të ditës vetëm për ndriçim publik, diskutojmë vetëm për këtë. Mos ta teprojmë tash me diskutime.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Jakup, nuk është në rregull me i bë kaq shumë pyetje, sepse po konsumohet koha.

**z.Sokol Haliti, kryetar i komunës:** Po du me qenë parimor. Dëgjoni, asnjë fjali nuk e kam fol palidhje, në secilën fjali e kam thanë me respekt një gjë. Ta keni parasysh për zonën ekonomike, zotimin e ka bë kuvendi komunal e jo kryetari. Ta kishe parasysh këtë, plani zhvillimore komunal është kry nga ana e komunës, ka shku në ministri, kame prit 2 muaj mu taku me një zëvendës ministër në Ministrinë e Infrastrukturës për rrugën. Hajde ti me mu shkojmë bashkë masi je shef i grupit të LVV-së. Unë jam që të bashkëpunojmë së bashku në interes të qytetarëve. Rruga e Stublles, e Godenit, sistemi i ujit në Skifteraj është bë me qellim, të jesh i bindur që është bë me qellim. Ti i ki bindjet e tua, ama unë po të thamë që me qellim është bë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Nuk është në domenin tim. E du në seancën tjetër me e sjell këtu. Jakupi tha dy dite para zgjedhjeve kryetari ka nënshkru marrëveshje. Unë po të thamë që, për 13 lokalitete e ke votu edhe ti, ka qenë marrëveshja për ujë, në seancën e radhës kemi me pru e me pa a është dy ditë para zgjedhjeve dhe e sheh që për 13 fshatra e kemi nënshkru marrëveshjen me CDI. Këshilltarja tha lavdron pas projekteve te qëndrueshme. Unë e di që se ke qenë e re ti tu u rrit kur jemi ardh na me do xhipa të bardhë të cilët tash nuk janë. E kemi nxjerr Budrikën prej ujit edhe prej atij viti ma nuk ka pas problem ne Budrikë. A nuk është projekt i qëndrueshëm ky a. Tash po debatojmë vetëm për shkollën e Pozharanit, u mbyll cikli i shkollave, i infrastrukturave, tash ku jeton ti aty ki me trotuar, me rrugë me ndriçim e kanalizim e shume hapësira tjera gjelbëruese, e ti nëse e konsideron shpenzime të lluksit kur të vinë shtetet evropiane ne Viti me shoqëri kulturore-

artistike, e Vitinë e shtinë me një kart të veten, e ti me i qujt shpenzime të lluksi, unë me këtë kurrë nuk pajtohem. E për atë shëtitoren qe po e përmend ti, janë shënimet sa mbeturina janë hek nga aty. Lumin “Morava” në çfarë gjendje e kemi kthy tani. Krejt këto janë projekte të qëndrueshme.

**z.Bekim Azizi, Kryesues i kuvendit:** Tu e pas parasysh që është ora 12:00, kemi pauzë deri ne ora 13:00, vazhdojmë takimin pas pauzës. Për këtë seancë kemi parapa këtë:

## **R e n d d i t e**

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a katër e rregullt e KK-së.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshimin – plotësimin e emrit të shkollës së Mesme Profesionale.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se komitetit për Arsim, Kulturë, Rini e Sport për vitin 2022.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e shfuqizimit të vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fsh. Kabash, vendimi me Nr. 01-110/05-365 i datës 04.04.2022, me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor me Nr. 1987-2/22 e datës 29.04.2022.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien ne shfrytëzim të pronës komunale me Nr. 01-110/05-100 i datës: 01.03.2022.**
7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT.**
8. **Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për periudhën janar-maj 2022.**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Tu e pas parasysh që në seancë jemi 20 vet prezent, pas konsultimeve edhe me Fatlumin, që ka qen kryetar i komisioni për ndryshim plotësim të statutit, si propozues i kësaj pike, e tërheqim nga rendi i ditës piken me nr.3. Tu e pas parasysh edhe mungesën e drejtoreshës së Katastrit, piken me nr.6 e tërheku nga rendi i ditës. Ndërsa kemi një pikë shtesë nga ekzekutivi, si ndryshim plotësim, ndryshimin e vendimit të komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim me Nr. 01-110/05-473, i datës 04.05.2022. Është fjala për dy anëtar të propozuar nga ekzekutivi komunal të ndryshohen me kërkesën e anëtarëve te cilën me shkrim kanë kërku që të tërhiqen nga ky komision. Hapi diskutim, nëse ka për rend të ditës. Me 20 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim, miratohet rendi i ditës me ndryshim plotësimet.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a katër e rregullt e KK-së**

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Hapi debat për diskutim. Kush është për miratim të procesverbalit, 20 pro, 0 kundër 0 abstenim vota, u miratohet procesverbali.

**z.Durim Sylejmani:** Kryesues, kryetari nuk mu përgjigj, e sa herë që fillon debati, kryetari ik nga debati në kundërpërgjigjen në fjalën time. Unë i morra tri fjalë, me tha këshilltar i ri, po te shtin me fol edhe prapë për këshilltar të ri. E ni veten të privilegjuar që jam i ri. Me më shti mu dikush me fol, unë jam i aftë dhe di me fol, kështu që ata e kanë shti edhe ata e kanë shti shumë keq qe e ka bë një padi ndaj LVV-së, e qe e ka hëngër keq më tha, ka me të ngrit padi kryetari, ka qen edhe sportist, edhe e dinë shumë mirë që mbrojtja më e mirë është sulmi. Kështu që një sulm e ka bë një padi e ka bë e fatkeqësish qe e ka prek topin me dorë e kur ta prek topin

me dorë në futboll gjyqtari i jep karton të kuq ka me përjashtu prej lojës edhe jam i habitur nga e dëgjoj tu fol keq për qeverinë qendrore, ndërkohë shkon në ministri e ju jep te njoftem ju thotë hajde se njihemi moti.

**z.Naim Pira, drejtor:** Me gjithë respektin, tani jemi ne fazën e rendit të ditës së kuvendit, po e shfrytëzoj përvojën që kam qen kryesues i kuvendit në momentin që jemi hi në rend dite diskutohen pika e rendit të ditës.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Ti Durim djalë i ri duhet me ndëgju nga pak, duhet me kurrigju fjalorin, e pse e përcjell ti kryetari kur rrezohet e kur qohet se pasna ditë unë këtë.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

## **2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshimin – plotësimin e emrit të shkollës së Mesme Profesionale**

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Ky propozim vendim ka ardh me kërkesën e Drejtorisë së Arsimit, që shkolla profesionale baze Ligjit mbi Funkcionimin e Shkollave Profesionale të harmonizohet me ligjet ku shkolla e mesme profesionale dhe kërkesa që është ardh nga ministria të emërohet Institucioni i Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP), drejtoresha ishte ne takim me ministrin, kërkoj që bazuar ne ligjet të miratohet kjo pikë. Hapi debat për diskutim.

**z.Ali Bajrami:** Ne si grup parlamentar jemi pro këtij propozim vendimi.

**z.Taulant Haxhiu:** Edhe ne si grup parlamentar jemi pro këtij propozim vendimi.

**z.Jakup Demiri:** Edhe ne si grup parlamentar jemi pro këtij propozim vendimi.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Qes në votim për miratim. Me 20 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

## **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës së Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini e Sport për vitin 2022**

**z.Musli Nezir, kryesuesi i Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini e Sport:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Këtë plan e kemi bë në bashkëpunim me anëtarët e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini e Sport. Unë sot nuk do të zgjati shumë, plani i punës u nda në dy pjesë në pjesën e arsimit dhe në pjesën e kulturës, rinisë e sportit, prandaj materialin e keni marr me kohë, kërkojnë që të miratohet ky plan. Për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës, pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Me 20 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt kemi:

## **4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e shfuqizimit të vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash, vendimi me Nr. 01-110/05-365, i datës 04.04.2022, me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor me Nr. 1987-2/22 e datës 29.04.2022**

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Në fletën poseduese shkruan Lum, e për këtë u kthy i kundërligjshëm ky vendim. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Rmadan Deliu:** E lus drejtorin për kadastër, që ta rregullon këtë çështje, sepse aty nuk ka lum as nuk ka pas kurrë me parë.

**z.Nexhat Halili:** Ne seancën e tretë kur u miratu vendimi në fjalë, ne si këshilltar të LVV-së kemi apstenu, sepse ne patëm pas vërejtje tona. Na ka ardh keq prej banorëve të fshatit Kabash, mirëpo kemi pas vërejtje në fletën poseduese, sepse është cek aty lumi. Strukturat komunale nuk i kanë marr në konsideratë vërejtje tona ose nuk konsultohen me Zyrën Ligjore hiq, po po me vjen mirë që ministria e ka kthyer mbrapa këtë vendim. Neve nuk na vjen mirë për banorët e fshatit Kabash. Ne si LVV do të jemi pro fuqizimit të këtij vendimi. Po kërkoj nga institucionet që t'i rregullojnë këto probleme, edhe pse nuk e kemi vendimin e ministrisë që kërkon anulimin.

**z.Naim Pira:** A din ku kishte me qenë krejt problemi i kësaj nëse kryesuesi i kuvendit mos ta sillte në kuvend për shfuqizim, gabimet lëshimet mund të ndodhin. Qëllimi ke qenë në interes të qytetarëve të Kabashit.

**z.Nexhat Halili:** Kur të është çështja e varrezave në Kabash, me vjen keq, mirëpo ne e kemi pa njësinë kadastrale, e kemi potencu ne edhe e kam me veti, ku e kemi potencu ne më mirë ka qenë mu rregullu e mos me votu.

**z.Ramadan Deliu:** Aty nuk ka pas as njëherë lum, e mos te vjen keq me votu pro anulimit, sepse nuk ke votu as pro këtij vendimi.

**z.Jakup Demiri:** Mos ta politizojmë më shumë këtë çështje në KPF. Të kam thanë Ramadan që nuk banë me shku kështu, të kam thanë rregullone këtë edhe e votojmë të gjithë, sepse e kam pas bindjen që në ministri kjo nuk kalon kështu.

**z.Ali Bajrami:** Fakt që e kemi diskutu këtë temë. Është bë një lëshim procedural, ekziston mundësia e shqyrtimit, e kemi obligim ligjor që ta shfuqizojmë ne tani, besoj që në seancat e radhës të vjen konform dispozitave ligjore.

**z.Basri Sylejmani:** Kur të janë në pyetje varrezat, nuk duhet me na pengu asgjë.

**z.Illir Zuka:** Kjo është e ndjeshme në momentin që e kemi miratu vendimin për me kalu ka qenë në të mirë të banorëve të fshatit Kabash. Tash ministria ka thanë që është në kundërshtim me ligjet, tash e shfuqizojmë edhe nuk kemi diskutim më shumë për këtë temë.

**z.Remzi Salihu:** Po flasim për një çështje që na intereson ta politizojmë, mirëpo megjithatë kjo pika ka ardh e nxitume qysh në seancën e parë e ku në mbledhjen e kalume nuk janë ndegju vërejtjet tona hiq, as ne nuk jemi kundër varrezave, po ne i kemi pa vërejtjet te mësoni ta përfillim ligjin, sepse parcela nuk ka qenë e ndarë mirë, po ta shfuqizojmë tashti e mos të bëjmë më shumë polemika, bile bile kur u votu ky vendim, LVV ka abstenu e unë kam qenë kundër, kam votu kundër atij vendimi, nuk kam qenë kundër varrezave po kundër procedurës.

**z.Musli Neziri:** Nga të gjithë u tha mos ta politizojmë këtë, po po shihet që u politizoi. Unë nuk jam kundër ligjit, po po ju thamë kur do që vjen, jo vetëm për Kabash, po për krejt fshatrat e Komunës së Vitisë për lokacion të varrezave. Vota ime është pro.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit:** Kjo duhet të jet një vërejtje për drejtorin, sepse propozim vendimet duhet me i dërgu në Zyrën Ligjore e ne me pas konfirmim dispozitav ligjor. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes ne votim për miratim. Me 20 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ne kuadër të rregullimi të planit urbanistik, që në bashkëpunim me kolegjin UBT, planin rregullativ, është në përfundim e sipër, është dorëzuar në ministri. Tash po e presim konfirmimin e ministrisë e tani kalojmë tek përgatitja e hartave zonale, e ku e kemi një marrëveshje që është bë për hartat zonale me kolegjin UBT. Në kuadër të kësaj e kemi të nënshkrime marrëveshjen nga ne. Është kërku që të ketë miratim në kuvend. Hapi debat për këtë pikë.

**z.Musli Nezir:** Sa i përket marrëveshjes, neve ne material na ka ardh vetëm propozim vendimi, e tash në seancë erdh marrëveshja. Unë pyes: pse nuk ka ardh me kohë edhe marrëveshja, që me pa ne, me e analizu. Prandaj po me doket kohë e shkurt që me e analizu tani për tani.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Edhe ne si kuvendi kur e kemi shpërnda materialin nuk e kemi pas një dokument edhe ne KPF e kemi diskutu që nuk e kemi pas materialin.

**z.Jakup Demiri:** Kjo puna e nënshkrimit të marrëveshjen me UBT ka qenë edhe marrëveshje e mëhershme. Ka qenë diçka që nuk na ka pëlqy, nëse sepse nuk ka pas transparent dhe kemi konsideru që ka qenë konflikt interesi, atëherë edhe prapë tash konflikt i interesit, dhe materialin që e sjellni sot. Kjo nuk ka dyshim, materialin të vjen në seancë e ku ka qenë dashur të analizohet kjo pikë e rendit të ditës. Kjo kushton 140 mijë euro, e ku 70 mijë euro komuna e 70 mijë euro UBT, e këto 70 mijë euro kujt ka me ja qit kolegji UBT.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pikërisht këtë vendim që e bëjmë sot, neve na jek dilemat a është konform ligjit apo jo, sepse kjo shkon në ministri dhe nëse nuk është konform ligjit kthehet. Me këtë vendim sot që e miratojmë e konfirmojmë a është konform ligjit kjo a po jo. Unë jam për që ta votojmë sot.

**z.Ali Bajrami:** Ne e dimë problematiken e planit zhvillimor komunal edhe hartës zonale. Unë kërkoj që të miratohet ky propozim vendim e të hecim tutje me planin e me hartat zonale.

**z.Taulan Haxhiu:** Paska material kogjo shumë. Ne do ta votomi, po ndoshta ministria do të naj kthen. Unë jam skeptik që do të jet në rregulle me këtë.

**z.Jakup Demiri:** Unë po ju lus, jo që jam kundër, po jemi të paarsyeshëm e shumë qesharak me e votu një dokument që nuk e kemi lexu. Ky dokument tani na erdh në kuvend, ka qenë dashur me ardh një javë përpara ky dokument. Jemi tu diskutu për një dokument shumë të rëndësishëm. Unë jam kundër kësaj, po kërkoj që edhe ju të jeni kundër.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Marrëveshja është e nënshkrime. Ne nuk po bëjmë marrëveshje, ne vetëm po e qojmë në ministri, e që me vërtetu që a është marrëveshja në rregull. Për këtë unë jam për me e votu.

**z.Ali Bajrami:** Si këshilltar komunal jemi autonom në votimin tonë. Unë e kam mandatin e tretë, kurrë asnjë këshilltar, të as një përbërje nuk e kam fy dhe as nuk është në domenin tim. Mirë, krejt jemi te zgjedhur dhe të votuar, po mi than këshilltari për votën pro, kundër ose që absteno, jeni qesharak, nuk po me duket e hijshme.

**z.Illir Zuka:** Jakupi në KPF e ka votu, që kjo të vihet në kuvend, e po e pyes Jakupin a ke qenë qesharak në KPF kur e ke votu pro këtë.

**z.Jakup Demiri:** Në KPF nuk e kemi pas materialin, e kanë propozu që me na ardh në kuvend masdite. Fjala ka qenë që me ardh materiali në kuvend komplet e jo si sot që ka ardh marrëveshja. Ka qenë dashur me na ardh me material.

**z.Remzi Salihu:** Unë vetëm kam një pyetje: a ka Zyre Ligjore Komuna e Vitisë? E nëse ka, a paguhen ata njerëz? Edhe nëse paguhen, pse paguhen, apo a ka komunikim me Zyrën Ligjore?

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë nuk e kam për obligim me i qu në Zyrën Ligjore, po mu më vijnë pikat nga drejtoritë. Drejtorat e kanë për obligim me u konsultu me Zyrën Ligjore. Po kemi Zyre Ligjore, paguen ata.

**z.Naim Pira drejtori:** Kjo është një pikë e rëndësishme për Komunën e Vitisë, sepse kemi të bëjmë me hartat zonale. Më pëlqej mendimi i kryesuesit, që të dërgojmë tutje në ministri. Nëse është në kundërshtim me ligjin, e kthen e shfuqizojmë, edhe nuk bëhet nami, po është në interes të Komunës së Vitisë me kalu kjo marrëveshje.

**z.Basri Aliu:** Nuk jemi tu i votu ne hartat zonale, po marrëveshjen me një investitor, që është participim me Komunën e Vitisë me e zgjedh një institucion që kanë me i përgatit hartat zonale, e duhet me ardh prapë në kuvend për me i miratu. Unë nuk kam të drejtë me votu, po, po ju kërkoj që ta votoni ju këtë.

**z.Nexhat Halili:** A ekziston esencialish vetëm UBT që e kryen këtë punë apo ka edhe të tjera, sepse nëse ka, ka qenë dashur të udhëheqin procedurat e prokurimit.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes ne votim për miratim. Me 15 vota pro, 4 kundër, 1 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

#### **6. Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për periudhën janar-maj 2022**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Bazuar ne planin e punës të kuvendit komunal, sot para juve ju kemi sjellë këtë informatë. Hapi debat për diskutim. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës e kemi:

**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësim ndryshimin e vendimit të komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim me Nr. 01-110/05-473, i datës 04.05.2022**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Me kërkesën me shkrim të Ahmet Arifit dhe Syle Salihut, të cilët kërkojnë të lirohen nga ky komision, sot do të votohet ndryshim plotësimi, ku janë Hidajete Aliu dhe Albulena Haxhiu, ndërsa anëtarët e tjerë nuk ndryshohen. Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka, e qes në votim për miratim. Me 20 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Ju faleminderit për kontributin e dhënë në këtë seancë! Shihem në mbledhjet tjera!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min.

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Bekim Azizi**